



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.69

2005

15 shtator

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i ERE nr.40, datë 31.8. 2005	Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë familjare..... 2415
Vendim i ERE nr.41, datë 31.8.2005	Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë jofamiljare..... 2420
Vendim i ERE nr.42, datë 31.8.2005	Për shfuqizimin e vendimit nr.11, datë 31.7.2002 “Për miratimin e kontratave të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve të kategorisë familjare dhe konsumatorëve të kategorisë B dhe C”..... 2426
Vendim i ERE nr.43, datë 31.8.2005	Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Sarmier” sh.p.k..... 2426
Vendim i ERE nr.44, datë 31.8.2005	Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Emikel” sh.p.k..... 2427
Vendim i ERE nr.45, datë 31.8.2005	Për mospranimin për shqyrtim të njoftimit për paraqitjen e aplikimit për ndërtimin dhe instalimin e H/C të ri nga shoqëria “Hidroinvest”sh.p.k..... 2427
Vendim i ERE nr.46, datë 31.8.2005	Për vendosjen e gjobës ndaj shoqërisë “Sarmier” sh.p.k..... 2428
	2428

Vendim i ERE
nr.47, datë 31.8.2005

Për vendosjen e gjobës ndaj shoqërisë “Emikel” sh.p.k.....

Vendim i ERE
nr.48, datë 1.9. 2005

Për miratimin e rregullores “Për procedurat e zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit të Komisionerëve të ERE-s”.... 2429

VENDIM
Nr.40, datë 31.8. 2005

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE
PËR KLIENTIN E KATEGORISË FAMILJARE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 44 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.8.2005, pasi shqyrtoi draftin e kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë familjare,

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë familjare.
(Kontrata bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

Miraturar me vendimin nr.40, datë 31.8.2005 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s

KONTRATË
E
FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE
PËR KLIENTIN E KATEGORISË FAMILJARE

Kontratë nr. _____
E lidhur sot më datë _____, në _____
(zonën e shpërndarjes elektrike)

Nga palët në kontratë:

Furnizuesi _____
(Emri i kompanisë furnizuese)

(Emri, mbiemri i përfaqësuesit të kompanisë)

(Adresa e furnizuesit të licencuar, numri i telefonit, fax, e-mail, NIPT)

Klienti _____
(Emri, mbiemri i klientit familjar)

(Qyteti/ fshati, adresa, emërtimi i objektit, nr.telefonit, fax, e-mail)

(Dokument identifikimi, pasaportë / certifikatë)

1. OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është furnizimi me energji elektrike i konsumatorit të kategorisë familjare, nga furnizuesi, me fuqi të kërkuar _____ kW ose/limitator _____ A, me tension _____ V dhe tolerancë në kufijtë +/- 10 % për klientët e zonave urbane dhe me tension _____ V dhe tolerancë në kufijtë +10% / -15% për klientët e zonave rurale, sistem _____ fazor, frekuencë 50 Hz dhe tolerancë në kufijtë +/- 2 %.

2. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE

Furnizuesi merr përsipër t’i sigurojë klientit një shërbim efikas dhe cilësor për furnizimin me

energji elektrike. Kushtet e përgjithshme të përcaktuara në këtë kontratë janë të vlefshme për të gjithë klientët që kërkojnë shërbimin e furnizimit me energji elektrike dhe që kanë një kontratë të nënshkruar për furnizimin me energji elektrike. Me nënshkrimin e kontratës, palët marrin përsipër të zbatojnë legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. KONTRATA E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE

3.1 Nënshkrimi i kontratës

Kontrata e furnizimit me energji elektrike hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët. Furnizuesi duhet ta nënshkruajë kontratën brenda një muaji nga marrja e kërkesës së klientit për furnizimin me energji elektrike.

3.2 Kohëzgjatja e kontratës

Kjo kontratë është me afat të pacaktuar në kuptim të dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

3.3 Heqja dorë nga kontrata

Titullari i kontratës së furnizimit me energji elektrike (klienti) është përgjegjës për konsumin e energjisë elektrike deri në momentin e heqjes dorë nga kontrata. Nëse klienti kërkon të përfundojë kontratën e furnizimit me energji elektrike, ai duhet të njoftojë me shkrim furnizuesin 10 ditë kalendarike përpara heqjes dorë nga kontrata dhe të shlyejë të gjitha detyrimet ndaj furnizuesit.

4. ÇMIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

4.1 Përcaktimi i çmimit të energjisë elektrike

Në bazë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, çmimi i energjisë elektrike përcaktohet nga Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE).

4.2 Ndryshimi i çmimit

Ndryshimet e çmimit të energjisë elektrike bëhen me vendim të ERE-s. Palët në kontratë bien dakord që çdo ndryshim çmimi, i bërë me vendim të ERE-s, do të aplikohet automatikisht në kontratë. Furnizuesi e publikon vendimin për ndryshimin e çmimit nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit të paktën 15 ditë përpara aplikimit.

5. LEXIMI I MATËSIT DHE FATURIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Mënyra dhe afati i leximit

Furnizuesi do të lexojë dhe do të regjistrojë tregimin e numërorit të matësit të energjisë elektrike dhe mbi këtë bazë plotëson faturën tip të energjisë elektrike, të cilën ia dërgon klientit çdo muaj në adresën e dhënë në kontratë brenda datës 25 të muajit që bën leximin. Data e leximit të matësit i bëhet e njohur klientit në faturën që i dërgohet. Furnizuesi është i detyruar ta respektojë datën e leximit.

6. MËNYRA E PAGESËS

6.1 Pagesa dhe afati për kryerjen e saj

6.1.1 Klienti do të paguajë detyrimin e shkruar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), nga data 2 deri në fund të muajit pasardhës.

6.1.2 Klienti do të bëjë pagesën e faturës mujore të energjisë elektrike me një nga mundësitë që furnizuesi ka ofruar (nëpërmjet arkave të pagesës, bankave ose duke përdorur llogaritë bankare).

6.1.3 Për çdo mënyrë pagese të zgjedhur, klienti që në muajin paraardhës ia bën të ditur furnizuesit, po kështu vepron dhe kur e ndryshon atë.

6.2 Kamatëvonesa

Pas kalimit të afatit të pagesës, caktuar në pikën 6.1, klienti është i detyruar të paguajë një kamatëvonesë prej 0.5 % në ditë mbi shumën e detyrimit të faturës së papaguar, për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera e detyrimit në faturë.

6.3 Pasojat e mospagesës

6.3.1 Nëse klienti nuk paguan detyrimet që ka ndaj furnizuesit 30 ditë pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 6.1, furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit 72 orë përpara. Furnizuesi është i detyruar që të bëjë rilidhjen brenda 48 orësh nga kryerja e pagesës nga klienti.

6.3.2 Nëse klienti nuk e paguan detyrimin që ka ndaj furnizuesit brenda 3 muajve nga data e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike sipas pikës 6.3.1, atëherë furnizuesi ka të drejtë ta zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit me energji elektrike.

6.4 ANKIMI PËR FATURIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

6.4.1 Kur klienti dyshon në saktësinë e një matësi ose kur ka vënë re pasaktësi në matës, ai ka të drejtë të paraqesë në ERE një ankesë ndaj furnizuesit (me shkrim, me gojë, me telefon ose në rrugë elektronike), në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, por kjo nuk përjashton të drejtën e klientit në çdo rast për paraqitjen e një ankese drejtpërdrejt te furnizuesi.

6.4.2 Kur klienti i drejtohet furnizuesit për ankesën që ka në lidhje me sasinë e energjisë elektrike të faturuar, ai paraqet kërkesë me shkrim në zyrat e furnizuesit deri në pesë ditë përpara përfundimit të muajit të faturuar. Kur ankesa bëhet pasi veprimet me faturën kanë kaluar në arkë ose në bankë, ajo zgjidhet pasi është kryer pagesa e saj, brenda 30 ditëve nga data e bërjes së ankesës.

6.4.3 Mënyra e zgjidhjes së ankesës, bëhet sipas rregullave të aplikueshme nga furnizuesi, por që janë të bëra publike nga furnizuesi në të gjitha pikat ku furnizuesi pranon pagesat e faturave të energjisë elektrike apo ku janë sportelet dhe zyrat e tij. Për sasinë e kWh të faturuar tepër dhe që është paguar nga klienti bëhet zbritja në vlerën e faturës së muajve pasardhës, deri në shlyerjen e plotë të vlerës.

7. PAJISJET E FURNIZIMIT DHE TË MATJES

7.1 Instalimi, kolaudimi dhe pronësia

7.1.1 Furnizuesi me shpenzimet e veta instalon te klienti sistemin e matjes së energjisë elektrike dhe e lidh atë me rrjetin e shpërndarjes me nënshkrimin e kësaj kontrate. Para montimit të matësit në objekt, kur matësi është i përdorur më parë, furnizuesi kryen kolaudimin e matësit në laborator dhe kur parametrat e tij janë brenda kushteve të vendosura nga Kodi i Matjes, bën vulosjen e kapakut të makinerisë së matësit me vulën e laboratorit me shenjë _____.

Për matësin e ri krahas vulës së laboratorit me shenjë _____ ruhet e pa cenuar vula origjinale e prodhuesit.

7.1.2 Klienti, sipas udhëzimeve të furnizuesit, duhet të pajiset me një limitator, të cilin do ta vendosë brenda objektit për kufizimin e fuqisë maksimale të kërkuar. Shpenzimet për blerjen dhe instalimin e këtij limitatori përballohen nga vetë klienti, ndërsa karakteristikat e limitatorit përcaktohen nga furnizuesi.

7.1.3 Në rast se klienti kërkon shtesë fuqie mbi kufijtë e përcaktuar në kontratë, duhet t'i drejtohet me një kërkesë me shkrim furnizuesit konform rregullave për lidhjet e reja, të miratuara nga ERE. Furnizuesi i kthen përgjigje me shkrim klientit brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e paraqitjes së kërkesës.

7.1.4 Klienti është përgjegjës për ruajtjen (mbrojtjen) e sistemit matës të energjisë elektrike të vendosur nga furnizuesi brenda pronës së tij.

7.1.5 Klienti duhet t'i sigurojë mundësi inspektimi të sistemit të matjes apo të instalimit elektrik të objektit përfaqësuesit të furnizuesit, kur ky është i pajisur me autorizimin përkatës të furnizuesit.

7.1.6 Klienti është i detyruar që në instalimet e tij te objekti të bëjë dhe tokëzimin e përsëritur të neutrit, sipas kushtit teknik të miratuar nga Inspektorati i Pajisjeve Elektrike (IPE).

7.1.7 Klienti nuk mund t'u japë apo t'u shesë energji elektrike klientëve të tjerë nga rrjeti i tij. Nuk do të konsiderohet si aktivitet shpërndarje i klientit zotërimi, shfrytëzimi, administrimi dhe kontrolli i mjeteve të shpërndarjes të vendosura në pronën e tij private ose në pronën e tij private të dhënë me qira të tjerëve dhe që përdoren vetëm për të transportuar ose dhënë energji elektrike te personi që i zotëron, shfrytëzon, administron dhe i kontrollon këto mjete.

7.2 Kontrolli i aparatit matës

7.2.1 Furnizuesi ka të drejtë të kontrollojë me iniciativën e vet dhe/ose me kërkesë të klientit, brenda 15 ditëve nga bërja e kërkesës së këtij të fundit, saktësinë e aparatit matës të klientit duke iu referuar klasës së precizionit dhe shkallës së gabimit të lejuar sipas normave që përcakton Kodi i Matjes, dhe në çdo rast njofton klientin për rezultatin e kontrollit, me anë të një dokumenti shkresor, ku përshkruhen qartë rezultatet e kontrollit të matësit. Të dhënat e rezultuara nga kontrolli i matësit regjistrohen nga furnizuesi konform rregullave që kërkon Kodi i Matjes.

7.2.2 Kur furnizuesi vihet në dijeni të një kërkesë me shkrim dërguar në ERE, në bazë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 51 pika 2 për pasaktësinë në matës, ai merr masa për ta kontrolluar matësin dhe për ta riparuar dhe zëvendësuar atë, kur vërtetohet se mat gabim tej shkallës së lejuar, brenda një afati njëmuor nga data që ka marrë dijeni. Në të njëjtën mënyrë do të veprojë furnizuesi dhe kur merr njoftim drejtpërdrejt nga klienti.

7.2.3 Kur matësi i kontrolluar me kërkesë të klientit del brenda normave teknike të përcaktuara në Kodin e Matjes, shpenzimet për kontrollin (bazuar në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”) i ngarkohen klientit.

7.3 Faturimi i energjisë elektrike gjatë mosfunksionimit të aparatit matës

7.3.1 Faturimi i energjisë elektrike për ditët që blerësit i është hequr aparati matës, për shkak të kontrollit ose në rast të mosfunksionimit të aparatit matës, do të bëhet bazuar në konsumin mesatar ditor të muajit paraardhës, por jo më shumë se 30 ditë.

7.3.2 Nëse furnizuesi nuk respekton afatin për vendosjen e matësit të rregullt, atëherë përgjegjësia është e furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje tej këtij afati do të bëhet mbi bazën e konsumit mesatar ditor në muajin me konsumin më të ulët me matje të periudhës së mëparshme.

7.4 Ndërhyrja në sistemin e matjes

7.4.1 Kur përfaqësuesi i autorizuar nga furnizuesi ndërhyr në sistemin e matjes, të mbrojtjes apo edhe kryen një kontroll të instalimit elektrik të objektit, ai duhet të plotësojë një procesverbal tip të miratuar nga furnizuesi ku të shpjegohet veprimi i kryer. Procesverbali do të firmoset si nga përfaqësuesi i furnizuesit, ashtu edhe nga klienti, një kopje të të cilit e mban klienti.

7.4.2 Klienti duhet të njoftojë menjëherë furnizuesin në rast konstatimi të ndërrimit nga të tretë të fazës me neutrin, e cila ndihet menjëherë nga vënia në tension e karkasave të pajisjeve të nulifikuara, pasi ky veprim rrezikon jetën e njerëzve, si dhe krijon mundësi për vjedhje të energjisë elektrike.

8. NDËRPRERJA E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE

8.1 Furnizuesi ka të drejtë të kufizojë ose të ndërpresë (në përmasat e nevojshme) dhënien e energjisë elektrike kur:

a) Ka shkelje të rregullave të sigurimit teknik që lidhen me kërcënime direkte të jetës, shëndetit apo pasurisë së personave.

b) Klienti gjatë marrjes së energjisë elektrike përdor pajisje të cilat ndikojnë në cilësinë e energjisë elektrike në dëm të klientëve të tjerë dhe kur nuk janë zbatuar masat teknike të duhura për mënjanimin e këtij ndikimi.

c) Detyrohet të aplikojë reduktime të ngarkesës në raste të gjenerimit të pamjaftueshëm në sistemin elektroenergjetik dhe të kapaciteteve të pamjaftueshme transmetuese të linjave të interkonjeksionit me jashtë.

d) Ka raste të defekteve dhe/ose problemeve të operimit për qëndrueshmërinë e sistemit.

e) Ka ndërprerje aksidentale (të rastit) të furnizimit me energji elektrike.

f) Jepen urdhra nga shërbimi dispeçer konform akteve ligjore apo nënligjore në fuqi.

g) Në rrjetet elektrike kryhen punime mirëmbajtjeje dhe riparimi të programuara.

h) Ka situatë të gjendjes emergjente në furnizimin me energji elektrike, sipas nenit 47 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

i) Klienti merr energji elektrike në mënyrë të parregullt, ku përfshihen:

- marrja pa kontratë;

- marrja e saj përpara aparatit matës;

- marrja e saj me pajisje matëse që si pasojë e ndërhyrjes në to nuk regjistrohet ose regjistrohen vlera më të vogla se realiteti;

- marrja e saj me pajisje matëse të cilat nuk i ka lidhur furnizuesi.

- Në këto raste, furnizuesi për këtë fluks energjie të pamatur do të llogarisë dëmin ekonomik që i është shkaktuar (kWh dhe në lekë), bazuar në vendimet e ERE-s.

j) Klienti nuk ka paguar detyrimet, furnizuesi vepron sipas pikës 6.3.1.

8.2 Për rastet e ndërprerjeve të parashikuara në germa f dhe g të nenit 8 pika 8.1, furnizuesi do të bëjë njoftimin me mjetet e informimit publik, të paktën 24 orë para, duke treguar gjithashtu edhe orën kur fillon ndërprerja.

8.3 Furnizuesi nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmet që mund t’u vijnë klientëve, si rezultat i ndërprerjes apo kufizimeve të energjisë elektrike të parashikuara në pikën 8.2 të kësaj kontrate.

8.4 Furnizuesi mban përgjegjësi për dëmet që mund t’i vijnë klientit, në rast se këto dëme vijnë si rezultat i një veprimi apo mosveprimi të drejtpërdrejtë, me faj dhe kur veprohet në

kundërshtim me normat dhe rregullat në fuqi të furnizimit.

9. VEPRIMET PËR RASTET E NDËRPRERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

9.1 Për raste të ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike të klientit për defekte apo avari në rrjetet elektrike, furnizuesi do të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të rifilluar furnizimin normal.

9.2 Për raste të ndërprerjeve të programuara të furnizimit me energji elektrike, furnizuesi do t'i njoftojë klientët me mjetet e informimit publik, të paktën 24 orë përpara, duke u treguar dhe kohën e zgjatjes së ndërprerjes.

9.3 Furnizuesi është i detyruar t'u përgjigjet (ose duke e zgjidhur ankimin ose duke i dhënë përgjigje me shkrim) të gjitha ankimeve (reklamimeve) të adresuara nga klientët.

9.4 Çdo ankim do të ketë një numër të regjistruar, që do t'i komunikohet reklamuesit. Për çdo reklamim të mëvonshëm për moszgjidhje të ankesës, klienti do t'i referohet numrit të regjistruar.

9.5 Në rast të ndryshimit të adresës, furnizuesi sa më shpejt ia komunikon këtë klientit me mjete të ndryshme informative.

9.6 Në rast të ndërprerjes së kontratës së furnizimit me energji elektrike, furnizuesi të kryejë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientit, në pikën e lidhjes për rastin kur matësi është vendosur në boks individual, dhe në matës për rastin kur matësi është vendosur në boks kolektiv. Menjëherë pas ndërprerjes të kryhet leximi i matësit, të llogaritet fatura e fundit, si dhe të bëhet vulosja në pikën e ndërprerjes me një vulë të dallueshme nga ajo e lidhjes.

10. DETYRIME TË PËRBASHKËTA

10.1 Rrjeti shpërndarës, pajisjet dhe instalimet e përdoruesit, duhet t'u përgjigjen kushteve teknike të miratuara nga organet kompetente.

10.2 Përfaqësuesi i furnizuesit, i pajisur me autorizimin e lëshuar nga furnizuesi, realizon në prezencë të klientit kontrollin (pasi ka ndërprerë tensionin e furnizimit normal të objektit) në të gjitha pikat ushqyese të pajisjeve të klientit, për të verifikuar se klienti nuk merr tension nga ndonjë burim tjetër furnizimi.

10.3 Furnizuesi kontrollon punën e matësit në regjime të ndryshme ngarkese, duke kyçur në rrjet pajisjet e ndryshme të përdoruesit.

10.4 Furnizuesi është përgjegjës për cilësinë e kontakteve të lidhjes së përcjellësve të furnizimit në morseterinë e matësit.

10.5 Pasi të dyja palët sigurohen për funksionimin normal të skemës së furnizimit dhe të matjes, përfaqësuesi i furnizuesit, në prezencë të klientit, vulos kapakun e morseterisë së matësit dhe elemente të tjera të sistemit të matjes, si dhe regjistron në kontratë:

Vulën e kapakut të morseterisë	_____
Vulën e boksit individual	_____
Vulën e limitatorit para matësit	_____
Numrin e serisë së matësit	_____
Leximin aktual të tregimit të matësit	_____
Numrin e fazave të matësit	_____
Emrin e kabinës elektrike nga ku furnizohet	_____

Si dhe një skemë të thjeshtë elektrike të furnizimit përfshirë matësin, ku të përcaktohen kufijtë e përgjegjësisë së furnizuesit, si dhe kufijtë e përgjegjësisë së klientit.

Skema elektrike e furnizimit

11. DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo kontratë mund të përfundohet nga palët sipas rregullave të përcaktuara në këtë kontratë apo të dispozitave të Kodit Civil.

12. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet e tyre, në rast të kundërt do t'i drejtohen ERE-s ose gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

13. HYRJA NË FUQI

Kjo kontratë hyn në fuqi më datë 1.1.2006.

FURNIZUESI

KLIENTI

VENDIM

Nr.41, datë 31.8.2005

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR
KLIENTIN E KATEGORISË JOFAMILJARE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 44 pika 3 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.8.2005, pasi shqyrtoi draftin e kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë jofamiljare,

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientin e kategorisë jofamiljare. (Kontrata bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

Miratuar me vendimin nr. 41, datë 31.8.2005 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s

KONTRATË

E

**FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE
PËR KLIENTIN E KATEGORISË JOFAMILJARE**

Kontratë nr. _____

E lidhur sot më datë _____, në _____

(zonën e shpërndarjes elektrike)

Nga palët në kontratë:

Furnizuesi _____
(Emri i kompanisë furnizuese)

(Emri, mbiemri i përfaqësuesit të kompanisë)

(Adresa e furnizuesit të licencuar, numri i telefonit, fax, e-mail, NIPT)

Klienti _____
(Emri, mbiemri i klientit familjar)

(Qyteti/ fshati, adresa, emërtimi i objektit, nr.telefonit, fax, e-mail)

(Dokument identifikimi, pasaportë / certifikatë)

1. OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është furnizimi me energji elektrike i konsumatorit të kategorisë familjare, nga furnizuesi, me fuqi të kërkuar _____ kW ose/limitator _____ A, me tension _____ V dhe tolerancë në kufijtë +/- 10 % për klientët e zonave urbane dhe me tension _____ V dhe tolerancë në kufijtë +10% / -15% për klientët e zonave rurale, sistem _____ fazor, frekuencë 50 Hz dhe tolerancë në kufijtë +/- 2 %.

2. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE

Furnizuesi merr përsipër t'i sigurojë klientit një shërbim efikas dhe cilësor për furnizimin me energji elektrike. Kushtet e përgjithshme të përcaktuara në këtë kontratë janë të vlefshme për të gjithë klientët që kërkojnë shërbimin e furnizimit me energji elektrike dhe që kanë një kontratë të nënshkruar për furnizimin me energji elektrike. Me nënshkrimin e kontratës, palët marrin përsipër të zbatojnë legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. KONTRATA E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE

3.1 Nënshkrimi i kontratës

Kontrata e furnizimit me energji elektrike hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët. Furnizuesi duhet ta nënshkruajë kontratën brenda një muaji nga marrja e kërkesës së klientit për furnizimin me energji elektrike.

3.2 Kohëzgjatja e kontratës

Kjo kontratë është me afat të pacaktuar në kuptim të dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

3.3 Heqja dorë nga kontrata

Titullari i kontratës së furnizimit me energji elektrike (klienti) është përgjegjës për konsumin e energjisë elektrike deri në momentin e heqjes dorë nga kontrata. Nëse klienti kërkon të përfundojë kontratën e furnizimit me energji elektrike, ai duhet të njoftojë me shkrim furnizuesin 10 ditë kalendarike përpara heqjes dorë nga kontrata dhe të shlyejë të gjithë detyrimet ndaj furnizuesit.

4. ÇMIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

4.1. Përcaktimi i çmimit të energjisë elektrike

Në bazë të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", çmimi i energjisë elektrike përcaktohet nga Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE).

4.2. Ndryshimi i çmimit

Ndryshimet e çmimit të energjisë elektrike bëhen me vendim të ERE-s. Palët në kontratë bien dakord që çdo ndryshim çmimi, i bërë me vendim të ERE –s, do të aplikohet automatikisht në kontratë. Furnizuesi e publikon vendimin për ndryshimin e çmimit, nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit, të paktën 15 ditë përpara aplikimit.

5. LEXIMI I MATËSIT DHE FATURIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Mënyra dhe afati i leximit

Furnizuesi do të lexojë dhe do të regjistrojë tregimin e numërorit të matësit të energjisë elektrike dhe mbi këtë bazë plotëson faturën tip të energjisë elektrike, të cilën ia dërgon klientit çdo muaj në adresën e dhënë në kontratë brenda datës 25 të muajit që bën leximin. Data e leximit të matësit i bëhet e njohur klientit në faturën që i dërgohet. Furnizuesi është i detyruar ta respektojë datën e leximit.

6. MËNYRA E PAGESËS

6.1 Pagesa dhe afati për kryerjen e saj

6.1.1 Klienti do të paguajë detyrimin e shkruar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), nga data 2 deri në fund të muajit pasardhës.

6.1.2 Klienti do të bëjë pagesën e faturës mujore të energjisë elektrike me një nga mundësitë që furnizuesi ka ofruar (nëpërmjet arkave të pagesës, bankave ose duke përdorur llogaritë bankare).

6.1.3 Për çdo mënyrë pagese të zgjedhur, klienti që në muajin paraardhës ia bën të ditur furnizuesit, po kështu vepron dhe kur e ndryshon atë.

6.2. Kamatvonesa

Pas kalimit të afatit të pagesës, caktuar në pikën 6.1, klienti është i detyruar të paguajë një kamatëvonesë prej 0.5 % në ditë mbi shumën e detyrimit të faturës së papaguar, për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera e detyrimit në faturë.

6.3 Pasojat e mospagesës

6.3.1 Nëse klienti nuk paguan detyrimet që ka ndaj furnizuesit 30 ditë pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 6.1, furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit 72 orë përpara. Furnizuesi është i detyruar që të bëjë rilidhjen brenda 48 orësh nga kryerja e pagesës nga klienti.

6.3.2 Nëse klienti nuk e paguan detyrimin që ka ndaj furnizuesit brenda 3 muajve nga data e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike sipas pikës 6.3.1, atëherë furnizuesi ka të drejtë ta zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit me energji elektrike.

6.4. ANKIMI PËR FATURIMIN E ENERGJISË ELKTRIKE

6.4.1 Kur klienti dyshon në saktësinë e një matësi ose kur ka vënë re pasaktësi në matës, ai ka të drejtë të paraqesë në ERE një ankesë ndaj furnizuesit (me shkrim, me gojë, me telefon ose në rrugë elektronike), në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, por kjo nuk përjashton të drejtën e klientit në çdo rast për paraqitjen e një ankese drejtpërdrejt te furnizuesi.

6.4.2 Kur klienti i drejtohet furnizuesit për ankesën që ka në lidhje me sasinë e energjisë elektrike të faturuar, ai paraqet kërkesë me shkrim në zyrat e furnizuesit deri në pesë ditë përpara përfundimit të muajit të faturuar. Kur ankesa bëhet pasi veprimet me faturën kanë kaluar në arkë ose në bankë, ajo zgjidhet pasi është kryer pagesa e saj, brenda 30 ditëve nga data e bërjes së ankesës.

6.4.3 Mënyra e zgjidhjes së ankesës, bëhet sipas rregullave të aplikueshme nga furnizuesi, por që janë të bëra publike nga furnizuesi në të gjitha pikat ku furnizuesi pranon pagesat e faturave të energjisë elektrike apo ku janë sportelet dhe zyrat e tij. Për sasinë e kWh të faturuar tepër dhe që është paguar nga klienti bëhet zbritja në vlerën e faturës së muajve pasardhës, deri në shlyerjen e plotë të vlerës.

7. PAJISJET E FURNIZIMIT DHE TË MATJES

7.1 Instalimi, kolaudimi dhe pronësia

7.1.1 Furnizuesi me shpenzimet e veta instalon te klienti sistemin e matjes së energjisë elektrike dhe e lidh atë me rrjetin e shpërndarjes me nënshkrimin e kësaj kontrate. Para montimit të matësit në objekt, kur matësi është i përdorur më parë, furnizuesi kryen kolaudimin e matësit në laborator dhe kur parametrat e tij janë brenda kushteve të vendosura nga Kodi i Matjes, bën vulosjen e kapakut të makinerisë së matësit me vulën e laboratorit me shenjë _____.

Për matësin e ri krahas vulës së laboratorit me shenjë _____ ruhet e pa cenuar vula origjinale e prodhuesit.

7.1.2 Klienti, sipas udhëzimeve të furnizuesit, duhet të pajiset me një limitator, të cilin do ta vendosë brenda objektit për kufizimin e fuqisë maksimale të kërkuar. Shpenzimet për blerjen dhe instalimin e këtij limitatori përballohen nga vetë klienti, ndërsa karakteristikat e limitatorit përcaktohen nga furnizuesi.

7.1.3 Në rast se klienti kërkon shtesë fuqie mbi kufijtë e përcaktuar në kontratë, duhet t'i drejtohet me një kërkesë me shkrim furnizuesit konform rregullave për lidhjet e reja, të miratuara nga ERE. Furnizuesi i kthen përgjigje me shkrim klientit brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e paraqitjes së kërkesës.

7.1.4 Klienti është përgjegjës për ruajtjen (mbrojtjen) e sistemit matës të energjisë elektrike të

vendosur nga furnizuesi brenda pronës së tij.

7.1.5 Klienti duhet t'i sigurojë mundësi inspektimi të sistemit të matjes apo të instalimit elektrik të objektit përfaqësuesit të furnizuesit, kur ky është i pajisur me autorizimin përkatës të furnizuesit.

7.1.6 Klienti është i detyruar që në instalimet e tij të objekti të bëjë dhe tokëzimin e përsëritur të neutrit sipas kushtit teknik të miratuar nga Inspektorati i Pajisjeve Elektrike (IPE).

7.1.7 Klienti nuk mund t'u japë apo t'u shesë energji elektrike klientëve të tjerë nga rrjeti i tij. Nuk do të konsiderohet si aktivitet shpërndarjeje i klientit zotërimi, shfrytëzimi, administrimi dhe kontrolli i mjeteve të shpërndarjes të vendosura në pronën e tij private ose në pronën e tij private të dhënë me qira të tjerëve dhe që përdoren vetëm për të transportuar ose dhënë energji elektrike të personi që i zotëron, shfrytëzon, administron dhe i kontrollon këto mjete.

7.1.8 Furnizuesi përcakton kushtet teknike të instalimit të burimit zëvendësues (gjenerim rezervë) pronë e klientit, për furnizimin me energji elektrike të objekteve të tij, si dhe kushtet që duhet të plotësohen nga ky burim zëvendësues për të mos sjellë shqetësime në rrjetin e furnizimit. Kushtet janë të detyrueshme për klientët.

7.1.9 Klienti që kërkon të instalojë burim zëvendësues do të respektojë detyrimisht kërkesat e mëposhtme:

- Instalimi duhet të plotësojë kërkesat teknike për të qenë i shkëputur nga rrjeti i shpërndarjes gjatë kohës kur gjenerimi rezervë është në punë.

- Komisionimi dhe vënia në punë e gjeneruesve rezervë të lidhur në nivelin e tensionit mbi 1 kV, do të realizohet në një rakordim të plotë me përfaqësuesit e njësisë që administron nënstacionet transformuese, deri në nivelin e tensionit ku realizohet kjo lidhje dhe qendrës dispeçer, duke plotësuar kërkesat teknike të Kodit të Shpërndarjes dhe Kodit të Transmetimi.

- Kapaciteti i burimit zëvendësues (gjenerimi rezervë) duhet të jetë i tillë që të mbulojë vetëm nevojat vetjake të klientit dhe të mos emetojë energji elektrike në rrjetin shpërndarës.

7.1.10 Klienti duhet të marrë masa teknike që koeficienti i fuqisë ($\cos\phi$) të jetë në përputhje me normat e lejuara në rregullat dhe rregulloret në fuqi, si dhe në përputhje me Kodin e Shpërndarjes dhe Kodin e Transmetimit.

7.1.11 Klienti do t'i sigurojë furnizuesit vazhdimisht të dhëna të cilat janë të parashikuara në Kodin e Shpërndarjes, si dhe akses për inspektim të burimit zëvendësues.

7.2 Kontrolli i aparatit matës

7.2.1 Furnizuesi ka të drejtë të kontrollojë me iniciativën e vet dhe/ose me kërkesë të klientit, brenda 15 ditëve nga bërja e kërkesës së këtij të fundit, saktësinë e aparatit matës të klientit duke iu referuar klasës së precizionit dhe shkallës së gabimit të lejuar sipas normave që përcakton Kodi i Matjes dhe në çdo rast njofton klientin për rezultatin e kontrollit me anë të një dokumenti shkresor, ku përshkruhen qartë rezultatet e kontrollit të matësit. Të dhënat e rezultuara nga kontrolli i matësit regjistrohen nga furnizuesi konform rregullave që kërkon Kodi i Matjes.

7.2.2 Kur furnizuesi vihet në dijeni të një kërkesë me shkrim dërguar në ERE, në bazë të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" neni 51 pika 2 për pasaktësinë në matës, ai merr masa për të kontrolluar matësin dhe për ta riparuar dhe zëvendësuar atë, kur vërtetohet se matësi gabim tej shkallës së lejuar, brenda një afati njëmuor nga data që ka marrë dijeni. Në të njëjtën mënyrë do të veprojë furnizuesi dhe kur merr njoftim drejtpërdrejt nga klienti.

7.2.3 Kur matësi i kontrolluar, me kërkesë të klientit, del brenda normave teknike të përcaktuara në Kodin e Matjes, shpenzimet për kontrollin (bazuar në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike") i ngarkohen klientit.

7.3. Faturimi i energjisë elektrike gjatë mosfunksionimit të aparatit matës

7.3.1 Faturimi i energjisë elektrike për ditët që blerësit i është hequr aparati matës, për shkak të kontrollit ose në rast të mosfunksionimit të aparatit matës, do të bëhet bazuar në konsumin mesatar ditor të muajit paraardhës, por jo më shumë se 30 ditë.

7.3.2 Nëse furnizuesi nuk respekton afatin për vendosjen e matësit të rregullt, atëherë përgjegjësia është e furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje tej këtij afati do të bëhet mbi bazën e konsumit mesatar ditor në muajin me konsumin më të ulët me matje të periudhës së mëparshme.

7.4. Ndërhyrja në sistemin e matjes

7.4.1 Kur përfaqësuesi i autorizuar nga furnizuesi ndërhyr në sistemin e matjes, të mbrojtjes apo edhe kryen një kontroll të instalimit elektrik të objektit, ai duhet të plotësojë një procesverbal tip të

miratuar nga furnizuesi ku të shpjegohet veprimi i kryer. Procesverbali do të firmoset si nga përfaqësuesi i furnizuesit ashtu edhe nga klienti, një kopje të të cilit e mban klienti.

7.4.2 Klienti duhet të njoftojë menjëherë furnizuesin në rast konstatimi të ndërrimit nga të tretë të fazës me neutrin, e cila ndihet menjëherë nga vënia në tension e karkasave të pajisjeve të nulifikuara, pasi ky veprim rrezikon jetën e njerëzve, si dhe krijon mundësi për vjedhje të energjisë elektrike.

8. NDËRPRERJA E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE

8.1 Furnizuesi ka të drejtë të kufizojë ose të ndërpresë (në përmasat e nevojshme) dhënien e energjisë elektrike kur:

a) Ka shkelje të rregullave të sigurimit teknik që lidhen me kërcënime direkte të jetës, shëndetit apo pasurisë së personave.

b) Klienti gjatë marrjes së energjisë elektrike përdor pajisje të cilat ndikojnë në cilësinë e energjisë elektrike në dëm të klientëve të tjerë dhe kur nuk janë zbatuar masat teknike të duhura për mënjanimin e këtij ndikimi.

c) Detyrohet të aplikojë reduktime të ngarkesës në raste të gjenerimit të pamjaftueshëm në sistemin elektroenergjetik dhe të kapaciteteve të pamjaftueshme transmetuese të linjave të interkonjeksionit me jashtë.

d) Ka raste të defekteve dhe/ose problemeve të operimit për qëndrueshmërinë e sistemit.

e) Ka ndërprerje aksidentale (të rastit) të furnizimit me energji elektrike.

f) Jepen urdhëra nga shërbimi dispeçer konform akteve ligjore apo nënligjore në fuqi.

g) Në rrjetat elektrike kryhen punime mirëmbajtjeje dhe riparimi të programuara.

h) Ka situatë të gjëndjes emergjente në furnizimin me energji elektrike, sipas nenit 47 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

i) Klienti merr energji elektrike në mënyrë të parregullt ku përfshihen:

- marrja pa kontratë;

- marrja e saj përpara aparatit matës;

- marrja e saj me pajisje matëse që si pasojë e ndërhyrjes në to nuk regjistrohet ose regjistrohën vlera më të vogla se realiteti;

- marrja e saj me pajisje matëse të cilat nuk i ka lidhur furnizuesi.

- Në këto raste furnizuesi për këtë fluks energjie të pamatur do të llogarisë dëmin ekonomik që i është shkaktuar (kWh dhe në lekë), bazuar në vendimet e ERE-s.

j) Klienti nuk ka paguar detyrimet, furnizuesi vepron sipas pikës 6.3.1.

8.2 Për rastet e ndërprerjeve të parashikuara në gerat f dhe g të nenit 8 pika 8.1, furnizuesi do të bëjë njoftimin me mjetet e informimit publik, të paktën 24 orë para, duke treguar gjithashtu edhe orën kur fillon ndërprerja.

8.3 Furnizuesi nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmet që mund t'i vijnë klientëve, si rezultat i ndërprerjes apo kufizimeve të energjisë elektrike të parashikuara në pikën 8.2 të kësaj kontrate.

8.4 Furnizuesi mban përgjegjësi për dëmet që mund t'i vijnë klientit, në rast se këto dëme vijnë si rezultat i një veprimi apo mosveprimi të drejtpërdrejtë, me faj dhe kur vepohet në kundërshtim me normat dhe rregullat në fuqi të furnizimit.

9. VEPRIMET PËR RASTET E NDËRPRERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

9.1 Për raste të ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike të klientit për defekte apo avari në rrjetet elektrike, furnizuesi do të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të rifilluar furnizimin normal.

9.2 Për raste të ndërprerjeve të programuara të furnizimit me energji elektrike, furnizuesi do të njoftojë klientët me mjetet e informimit publik, të paktën 24 orë përpara, duke u treguar dhe kohën e zgjatjes së ndërprerjes.

9.3 Furnizuesi është i detyruar t'u përgjigjet (ose duke e zgjidhur ankimin ose duke i dhënë përgjigje me shkrim) të gjitha ankimeve (reklamimeve) të adresuara nga klientët.

9.4 Çdo ankim do të ketë një numër të regjistruar, që do t'i komunikohet reklamuesit. Për çdo reklamim të mëvonshëm për moszgjidhje të ankesës, klienti do t'i referohet numrit të regjistruar.

9.5 Në rast të ndryshimit të adresës, furnizuesi sa më shpejt ia komunikon këtë klientit me mjete të ndryshme informative.

9.6 Në rast të ndërprerjes së kontratës së furnizimit me energji elektrike, furnizuesi të kryejë

ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientit, në pikën e lidhjes për rastin kur matësi është vendosur në boks individual, dhe në matës për rastin kur matësi është vendosur në boks kolektiv. Menjëherë pas ndërprerjes të kryhet leximi i matësit, të llogaritet fatura e fundit, si dhe të bëhet vulosja në pikën e ndërprerjes me një vulë të dallueshme nga ajo e lidhjes.

10. DETYRIME TË PËRBASHKËTA

10.1 Rrjeti shpërndarës, pajisjet dhe instalimet e përdoruesit, duhet t'i përgjigjen kushteve teknike të miratuara nga organet kompetente.

10.2 Përfaqësuesi i furnizuesit i pajisur me autorizimin e lëshuar nga furnizuesi, realizon në prezencë të klientit kontrollin (pasi ka ndërprerë tensionin e furnizimit normal të objektit) në të gjithë pikat ushqyese të pajisjeve të klientit për të verifikuar se klienti nuk merr tension nga ndonjë burim tjetër furnizimi.

10.3 Furnizuesi kontrollon punën e matësit në regjime të ndryshme ngarkese, duke kyçur në rrjet pajisjet e ndryshme të përdoruesit.


10.4 Furnizuesi është përgjegjës për cilësinë e kontakteve të lidhjes së përcjellësve të furnizimit në morseterinë e matësit

10.5 Pasi të dyja palët sigurohen për funksionimin normal të skemës së furnizimit dhe të matjes, përfaqësuesi i furnizuesit në prezencë të klientit vulos kapakun e morseterisë së matësit dhe elemente të tjera të sistemit të matjes, si dhe regjistron në kontratë:

Vulën e kapakut të morseterisë	_____
Vulën e boksit individual	_____
Vulën e limitatorit para matësit	_____
Numrin e serisë së matësit	_____
Leximin aktual të tregimit të matësit	_____
Numrin e fazave të matësit	_____
Emrin e kabinës elektrike nga ku furnizohet	_____

Si dhe një skemë të thjeshtë elektrike të furnizimit përfshirë matësin, ku të përcaktohen kufijtë e përgjegjësisë së furnizuesit, si dhe kufijtë e përgjegjësisë së klientit.

Skema elektrike e furnizimit



11. DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo kontratë mund të përfundohet nga palët sipas rregullave të përcaktuara në këtë kontratë apo të dispozitave të Kodit Civil.

12. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet e tyre, në rast të kundërt do t'i drejtohen ERE-s ose gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

13. HYRJA NË FUQI

Kjo kontratë hyn në fuqi më datë 1.1.2006.

FURNIZUESI

KLIENTI

VENDIM

Nr.42, datë 31.8.2005

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 11, DATË 31.7.2002 “ PËR MIRATIMIN E KONTRATAVE TË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE TË KONSUMATORËVE TË KATEGORISË FAMILJARE DHE KONSUMATORËVE TË KATEGORISË B DHE C”

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.8.2005,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.11, datë 31.7.2002 “ Për miratimin e kontratave të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve të kategorisë familjare dhe konsumatorëve të kategorisë B dhe C”.

Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.43, datë 31.8.2005

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS SË PARAQITUR NGA SHOQËRIA
“SARMIER” SHPK

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11 pika A dhe neni 22, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.8.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria Sarmier sh.p.k. për vendosjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria Sarmier sh.p.k. për vendosjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, pasi kërkesa nuk është bërë në përputhje me nenin 22 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.

2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve të njoftojë shoqërinë Sarmier sh.p.k. dhe ta informojnë atë për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.44, datë 31.8.2005

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS SË PARAQITUR NGA SHOQËRIA
“EMIKEL” SHPK

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11 pika A dhe neni 22, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.8.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria Emikel sh.p.k. për vendosjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria Emikel sh.p.k. për vendosjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, pasi kërkesa nuk është bërë në përputhje me nenin 22 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.

2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve të njoftojë shoqërinë Emikel sh.p.k. dhe

ta informojnë atë për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.45, datë 31.8.2005

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË NJOFTIMIT PËR PARAQITJEN E
APLIKIMIT PËR NDËRTIMIN DHE INSTALIMIN E H/C TË RI NGA SHOQËRIA
“HIDROINVEST” SHPK

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 pika 1, germa a, nenit 15 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të nenit 11 pika 2 të ligjit nr.7973, datë 25.7.1995 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, me ndryshimet përkatëse, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, me ndryshimet përkatëse, neni 11; Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.8.2005, pasi shqyrtoi njoftimin për paraqitjen e aplikimit për ndërtimin dhe instalimin e H/C të ri nga shoqëria Hidroinvest sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Për mospranimin për shqyrtim të njoftimit për paraqitjen e aplikimit për ndërtimin dhe instalimin e H/C të ri nga shoqëria Hidroinvest sh.p.k., pasi njoftimi dhe aplikimi duhet të kryhen nga shoqëria koncensionare në zbatim të nenit 4 të marrëveshjes së koncensionit miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.565, datë 12.8.2005.

2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe i Marrëdhënieve me Publikun dhe Departamenti i Licencave dhe Monitorimit të njoftojnë shoqërinë Hidroinvest sh.p.k. dhe ta informojnë atë për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm nga shoqëria koncensionare sipas pikës 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.46, datë 31.8.2005

PËR VENDOSJEN E GJOBËS NDAJ SHOQËRISË “SARMIER” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 64, pika 1 germa a të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.8.2005, pasi konstatoi se shoqëria “Sarmier” sh.p.k. nuk ka paraqitur raportin ekonomik- financiar për vitin 2004,

VENDOSI:

1. Të dënojë me gjobë shoqërinë “Sarmier” sh.p.k. me shumën prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.

2. Ngarkohet Departamenti i Administrimit, Financës dhe Burimeve Njerëzore, si dhe Departamenti i Licencave dhe Monitorimit për ndjekjen e ekzekutimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.47, datë 31.8.2005

PËR VENDOSJEN E GJOBËS NDAJ SHOQËRISË “ EMIKEL” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 64, pika 1 germa a të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike“, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.8.2005, pasi konstatoi se shoqëria “Emikel” sh.p.k. nuk ka paraqitur raportin ekonomiko- financiar për vitin 2004,

VENDOSI :

1. Të dënojë me gjobë shoqërinë “Emikel” sh.p.k. me shumën prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.

2. Ngarkohet Departamenti i Administrimit, Financës dhe Burimeve Njerëzore, si dhe Departamenti i Licencave dhe Monitorimit për ndjekjen e ekzekutimit të këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.48, datë 1.9. 2005

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË MBLEDHJEVE TË HAPURA TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S”

Mbështetur në nenin 3 pika 4 dhe nenin 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimin nr.26, datë 13.5.2004 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, me ndryshimet përkatëse, “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE”, neni 8 germa A, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.9.2005, mbasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe i Marrëdhënieve me Publikun, për rregulloren për procedurat e zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit të Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për procedurat e zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit të Komisionerëve të ERE-s”, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe i Marrëdhënieve me Publikun për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

Miratuar me vendim nr.48, datë 1.9.2005 të Bordit të Komisionereve të ERE-s

RREGULLORE
PËR PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË MBLEDHJEVE TË HAPURA TË BORDIT TË
KOMISIONERËVE

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe në përputhje me nenin 8 germa A “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s”.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë transparencën e mbledhjes së Bordit të Komisionerëve dhe t’u krijojë akses palëve të interesuara për të marrë pjesë në këto mbledhje.

Neni 3
Objekti

Përcaktimi i rregullave dhe procedurave të përgjithshme për zhvillimin e mbledhjeve të hapura të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

KAPITULLI II
PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË MBLEDHJEVE

Neni 4
Njoftimi i mbledhjes

ERE do të sigurojë njoftimin për publikun 48 orë para zhvillimit të një mbledhjeje të hapur të programuar të Bordit të Komisionerëve të ERE-s. Njoftimi do të përmbajë: datën, orën, vendin e zhvillimit të mbledhjes, si dhe rendin e ditës. Njoftimi për zhvillimin e mbledhjes vendoset në një vend të posaçëm në hyrje të ERE-s, si dhe publikohet në faqen zyrtare të ERE-s në internet.

Neni 5
Zhvillimi i mbledhjes

1. Para fillimit të çdo mbledhje vendimmarrëse të Bordit të Komisionerëve, sekretarja do të regjistrojë në një regjistër të posaçëm emrat e personave që kërkojnë të marrin pjesë në mbledhje.

2. Në momentin e hapjes së mbledhjes, sekretarja u bën të njohur pjesëmarrësve, nëpërmjet leximit, procedurat e zhvillimit të mbledhjes, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre.

3. Në një mbledhje të hapur të Bordit të Komisionerëve të ERE-s kanë të drejtë të diskutojnë dhe të japin mendime, vetëm anëtarët e Bordit të Komisionerëve dhe përfaqësuesit e ERE-s, si dhe me leje të Bordit edhe persona të tjerë që kanë lidhje me përgatitjen dhe administrimin e këtyre çështjeve.

4. Sekretarja do të regjistrojë në procesverbal të gjitha çështjet që u diskutuan nga Bordi dhe votimin për secilën çështje.

5. Me kërkesë të palëve të interesuara, sekretarja e Bordit do t’i lejojë ato të njihen me procesverbalin e mbledhjes, si dhe me vendimin e Bordit.

Neni 6

Të drejta e detyrime të publikut

1. Gjatë zhvillimit të një mbledhjeje vendimmarrëse të Bordit të Komisionerëve, çdo person që do të marrë pjesë ka të drejtë të dëgjojë e të mbajë shënime, por nuk ka të drejtë të flasë apo të bëjë pyetje, me përjashtim të rasteve kur Bordi e deklaron një gjë të tillë. Ndalohet gjithashtu ndërprerja e fjalës së diskutantit, përdorimi i celularëve dhe pirja e duhanit.

2. Nëse ndonjë nga personat pjesëmarrës në mbledhjen e Bordit të Komisionerëve do të konsiderohet se prish qetësinë dhe mbarëvajtjen e mbledhjes, me urdhër të kryetarit do të procedohet me largimin e tij.

3. Kur cenohen rregullat mbi zhvillimin e mbledhjes, kryetari vendos për ndërprerjen e mbledhjes, për jo më shumë se 30 minuta, ose shtyrjen e saj pas marrjes së miratimit nga Bordi.

KAPITULLI III
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 7

Amendamente të rregullores

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të Komisionerëve.

Neni 8

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE
4.	KODI PENAL
5.	KODI I PUNËS
6.	KODI I FAMILJES
7.	KODI CIVIL
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9.	KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 15.9.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 50 lekë